

VENDIM
Nr. 723, datë 11.11.2019

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 492, DATË 10.7.2019,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E ÇMIMEVE DHE TË
KATEGORIVE QË PËRFITOJNË FALAS TEKSTET E BOTUARA NGA QENDRA
E BOTIMEVE PËR DIASPORËN, PËR VITIN SHKOLLOR 2019–2020”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 5, të nenit 10, të ligjit nr. 16/2018, “Për diasporën”, të ligjit nr. 9616, datë 27.9.2006, “Për librin në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, të ndryshuar, dhe të pikës 19, të vendimit nr. 469, datë 26.7.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 492, datë 10.7.2019, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Qendra e Botimeve për Diasporën, me qëllim mundësimin e ruajtjes, të zhvillimit dhe mësimin të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare në diasporë, boton dhe siguron falas, për vitin shkollor 2019–2020, tekstet shkollore, sipas listës nr. 1, tekstet shkollore shtesë, sipas listës nr. 2, dhe literaturën plotësuese, sipas listës nr. 3, që i bashkëlidhen këtij vendimi.”

2. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Kategoritë që përfitojnë falas tekstet shkollore dhe ato të literaturës plotësuese, të botuara apo të siguruara nga Qendra e Botimeve për Diasporën, janë nxënësit dhe mësuesit, sipas përcaktimeve të vendimit nr. 443 datë 26.6.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin e procesit mësimor dhe përzgjedhjen e arsimtarëve në diasporë.”

3. Në pikën 4, pas fjalëve “... me listën 1,...” shtohen “... me listën nr. 2 dhe listën nr. 3,...”.

4. Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për sigurimin e teksteve shkollore dhe plotësuese, sipas listave nr. 1, nr. 2, e nr. 3, si dhe për shpërndarjen e teksteve shkollore shtesë dhe plotësuese të listave nr. 2 dhe nr. 3, bashkëlidhur, përballohen nga buxheti i miratuar për Qendrën e Botimeve për Diasporën.”

5. Pas listës nr. 1, bashkëlidhur vendimit, shtohen listat nr. 2 dhe nr. 3, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Lista nr. 2LISTA E TEKSTEVE SHKOLLORE SHITESË PËR DIASPORËN,
PËR VITIN SHKOLLOR 2019–2020

Nr.	Titulli	Tirazhi	Çmimi për copë / lekë
1	Abetare	81 copë	507
2	Fletore pune Abetare	81 copë	243
3	Gjuha shqipe 2	51 copë	453
4	Gjuha shqipe 3	51 copë	394
5	Gjuha shqipe 4	45 copë	460
6	Gjuha shqipe 5	37 copë	530
7	Gjuha shqipe 6	36 copë	539
8	Gjuha shqipe 7	36 copë	450
9	Gjuha shqipe 8	40 copë	410
10	Gjuha shqipe 9	40 copë	492
11	Gjuha shqipe 11	26 copë	350
12	Gjuha shqipe 12	26 copë	570
13	Të mësojmë gjuhën amtare 1	79 copë	346
14	Të mësojmë gjuhën amtare 2	58 copë	346
15	Të mësojmë gjuhën amtare 3	50 copë	346
	TOTALI	737 copë	304 563 lekë

*Në vlerën totale është përfshirë edhe TVSH-ja (për librin 6%).

Lista nr. 3LISTA E LITERATURËS PLOTËSUESE PËR MËSIMDHËNIEN
NË DIASPORË, PËR VITIN SHKOLLOR 2019–2020

Nr.	Titulli	Tirazhi	Çmimi për copë / lekë
1	LUAJ ME SHKRONJAT (Kuti kartoni që ka fisha me shkronja e figura dhe me CD) Shtëpia Botuese ALBAS	500 copë	954 lekë
2	SHKRONJAT (shkruaj, fshi, mëso) me laps magjik Shtëpia Botuese AEDITIONS	500 copë	500 lekë
3	NJË HAP DREJT SHKOLLËS (Paketë për fëmijë 5–6 vjeç) Shtëpia Botuese ALBAS	500 copë	2200 lekë
4	ÇUFOJA DHE BUBI KAÇURREL Shtëpia Botuese ÇABEJ	500 copë	750 lekë
5	TREGIME TË MOÇME SHQIPTARE (lidhje speciale) Shtëpia Botuese KUTELI '04	500 copë	2000 lekë

6	NJË ELEFANT ELEGANT (Përrallë me pengesa) Shtëpia Botuese BOTART	500 copë	400 lekë
7	50 PËRRALLAT MË TË BUKURA Shtëpia Botuese AEDITIONS	500 copë	1500 lekë
8	DI TË LUAJ DHE TË QESH (150 GJËEGJËZA) Shtëpia Botuese EXTRA	500 copë	300 lekë
9	FABULAT E EZOPIT (lidhje speciale) Shtëpia Botuese PEGI	500 copë	500 lekë
10	PRINCESHA ARGJIRO Shtëpia Botuese ONUFRI	500 copë	500 lekë
11	Malli për Mëmëdhenë Shtëpia Botuese MEDIAPRINT	500 copë	2500 lekë
	TOTALI	5500 copë	6 052 000 lekë

*Në vlerën totale është përfshirë edhe TVSH-ja (për librin 6%).